


[Tema Diplome Master Ekonomik.rar](#)

Studimi i parë zbuloi se cilësia e marrëdhënies mësues-nxënës në kopsht shërbente si bazë për rezultate të larta deri në klasën e tetë. Studimi i dytë konfirmoi rezultatet e studimit të parë, për nxënësit e vëzhguar nga arsimi parashkollor deri në klasën e pestë. Studimi i tretë analizoi rezultatet e Matematikës në dy shkolla të mëdha për nxënësit që kalonin nga klasa e tretë, në klasën e katërt dhe në klasën e pestë. Përsëri, cilësia e mësuesit ishte shumë e rëndësishme. Nxënësit që kishin pasur tre mësues të mirë njëri pas tjetrit ishin përpara nxënësve që kishin pasur mësues jo aq të mirë për një vit apo më shumë vite radhazi.

## Çfarë kuptojmë me mësimdhënie të mirë?

**Ç'është mësimdhënia e mirë?** Mësuesit e mirë janë të përkushtuar ndaj nxënësve të tyre. Ata përballen me një larmi fëmijësh me aftësi dhe probleme të ndryshme: gjuhë të ndryshme, situata të ndryshme familjare dhe aftësi të ndryshme vetjake. Ata duhet ta përshtatin mësimdhënien me nevojat e nxënësit. Gjatë gjithë kohës së trajtimit të materialit akademik, ata duhet të kujdesen edhe për nevojat emocionale të nxënësve, të ndihmojnë nxënësit të krijojnë një përfytyrim më të mirë për veten e tyre dhe të nxisin te ata ndjenjën e detyrës dhe të përgjegjshmërisë. Që nga dita e parë e mësimit, mësuesit e mirë tregojnë kujdes që nxënësit e tyre të përvetësojnë teknikat bazë të të jetuarit dhe të mësuarit.

**Cilat janë shqetësimet e mësuesve fillestarë?** Përsosja e aftësisë për të dhënë mësim është një proces gradual. Shqetësimet dhe problemet e mësuesve ndryshojnë nga njëra fazë në tjetrën. Në vitet e para, vëmendja e mësuesve të rinj përqendrohet te disiplina dhe motivimi i nxënësve, sheshimi i mosmarrëveshjeve midis tyre, vlerësimi i punës së tyre, marrëdhëniet me prindërit dhe komunikimi me mësuesit e tjerë. Me gjithë këto shqetësime, janë të shumtë mësuesit fillestarë që sjellin energji dhe krijimtari në punën e tyre, të cilën e përsosin nga viti në vit. Sa më shumë zgjerohet përvoja e mësuesit, aq më shumë dhe më mirë priret ai ndaj nevojave për zhvillimin profesional dhe rritjen e efektivitetit të punës së tij me kategoritë e ndryshme të nxënësve.

**Reflektiv** Krijues dhe analizues. Mësuesit reflektivë mendojnë për situatat në klasë dhe analizojnë atë që bëjnë, si dhe arsyet pse e bëjnë, me qëllim që të gjejnë rrugët e përmirësimit të punës së tyre me nxënësit.

## Roli i psikologjisë së edukimit

**Ç'është psikologjia e edukimit?** Qysh kur zuri fill, rreth një shekull më parë, psikologjia e edukimit është e lidhur me mësimdhënien në Shtetet e Bashkuara. Qëllimi i psikologjisë së edukimit është të kuptojë dhe të përmirësojë proceset e mësimdhënies dhe të të nxënit. Psikologët e edukimit krijojnë dije dhe metodologji. Gjithashtu, për të studiuar mësimdhënien dhe të nxënët në situata reale, ata përdorin njohuritë dhe metodologjitë e psikologjisë dhe disiplinave të tjera që kanë lidhje me të. Psikologët e edukimit studiojnë atë që ndodh kur *dikush* (mësuesit, prindërit apo kompjuteri) i mëson *diçka* (matematikë, vallëzim apo punë dore) *dikujt tjetër* (nxënësit, bashkëpunëtorit apo anëtarëve të tjerë të ekipit) në një *mjedis të caktuar* (klasë, teatër apo palestër).

**Ç'janë studimet përshkruese?** Raportet e studimeve përshkruese shpesh përfshijnë rezultatet e sondazheve, përgjigjet e intervistave, kampionët e dialogëve të zhvilluara në klasë apo regjistrimet e veprimtarive shkollore. Metodat etnografike përfshijnë studimin e ngjarjeve të natyrshme në jetën e grupit, duke synuar të nxjerrin kuptimin e këtyre ngjarjeve për njerëzit e përfshirë në to. Një rast studimor heton në thellësi mënyrën e përgatitjes së planeve mësimore apo mënyrën se si nxënësi/studenti përpiqet të zotërojë një material të caktuar.

**Ç'janë korrelacionet dhe studimet eksperimentale?** Një korrelacion është një numër që tregon si forcën, ashtu edhe drejtimin e lidhjes midis dy ngjarjeve apo dy matjeve. Sa më afër të jetë korrelacioni pranë numrit 1.00 ose -1.00, aq më e fortë është lidhja. Studimet eksperimentale synojnë të zbulojnë marrëdhëniet shkak-pasojë që kanë potencialin t'i ndihmojnë mësuesit të zbatojnë reforma të dobishme. Studiuesit nuk mjaftohen me vëzhgimin dhe përshkrimin e një situate të caktuar, por bëjnë ndryshime dhe mbajnë shënim rezultatet.

**Ç'janë studimet me një subjekt të vetëm dhe studimet mikrogjenetike?** Në studimet eksperimentale me një subjekt të vetëm, studiuesit analizojnë efektet e ndërhyrjeve te një person i vetëm, shpesh duke përdorur si pikë nisjeje një nivel të caktuar. Studimet mikrogjenetike përfshijnë një numër të shumtë vëzhgimesh të hollësishme të subjekteve për të gjurmuar ecurinë e ndryshimeve që nga çasti kur ato fillojnë deri në çastin kur procesi stabilizohet.

**Ç'është studimi në kushte konkrete?** Kur mësuesit bëjnë vëzhgime sistematike apo testojnë metodat e ndryshme për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënët në të mirë të nxënësve, thuhet se ata kryejnë studime në kushtet konkrete të klasës së tyre.

**Ç'është studimi i bazuar në shkencë?** Në mënyrë sistematike, studimi i bazuar në shkencë përdor vëzhgimet apo eksperimentet për të mbledhur të dhëna të vlefshme dhe të qëndrueshme. Ky lloj studimi përfshin procedura strikte dhe të përshtatshme për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Ai duhet të përshkruhet në mënyrë të hollësishme dhe të qartë, me qëllim që të mund të përsëritet nga njerëz të tjerë dhe t'i nënshtrohet analizave shkencore nga ekspertë të pavarur dhe të specializuar.

**Dallimi midis teorive dhe parimeve.** Një parim është një marrëdhënie e krijuar midis dy a më shumë faktorëve – për shembull, midis një strategjie të caktuar mësimdhënieje dhe rezultateve të nxënësve. Teoria është një grup konceptesh të ndërlidhura që përdoren për të shpjeguar një kategori të dhënash dhe për të bërë parashikime. Parimet e kërkimeve shkencore ofrojnë një numër përgjigjesh të mundshme për probleme të caktuara, ndërsa teoritë ofrojnë këndvështrime për analizën e thuajse çdo situate që mund të lindë.

**Psikologjia e edukimit** Disiplina që trajton proceset e mësimdhënies dhe të të nxënit duke përdorur metodat dhe teoritë e psikologjisë, por edhe metodat dhe teoritë e formuluara prej asaj vetë.

**Studimet përshkruese** Studime që mbledhin informacione të hollësishme rreth situatave të caktuara, shpesh duke përdorur vëzhgime, sondazhe, intervista, regjistrime apo një kombinim të

Tema Diplome Master Ekonomik.rar



# tema diplome master ekonomik

tema diplome master ekonomik

624b518f5d